



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 46 Akti

Nr. 60 Vendimi

Tiranë, më 01.08.2018

V E N D I M

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me anë të trupit gjykues të përbërë nga:

Roland Ilija
Xhensila Pina
Firdes Shuli

Kryesues
 Anëtare
 Relatore

me sekretare gjyqësore znj. Ina Serjanaj, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra, në Tiranë, në datat 30.07.2018, ora 12:00, dhe datë 01.08.2018, ora 15:00, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKT I RIVLERËSIMIT: **Z. Gentian Medja**, gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 179/b, A, Ç, D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, të ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji relatoren e çështjes Firdes Shuli, dëgjoji subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Gentian Medja, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 01.08.2018, kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Gentian Medja është subjekti i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, dhe ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë referuar si “ligji nr. 84/2016”), parashikojnë se të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Gentian Medja, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit dhe përkohësisht edhe të kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nga viti 2004 deri në vitin 2013 dhe aktualisht ushtron funksionin e gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që nga muaji nëntor 2013.

3. Bazuar në nenin 14, pika 2, të ligjit nr. 84/2016 dhe në “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit” të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (më poshtë referuar si “Komisioni”) është hedhur shorti në datën 30.11.2017, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Gentian Medja, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 1, i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Roland Ilia dhe Firdes Shuli. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes

Shuli. Me vendimin nr. 29, datë 23.05.2018, Komisioni ka vendosur që për arsye objektive, komisionerja Alma Faskaj të zëvendësohet nga komisionerja Xhensila Pine.

4. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka kryer një procedurë të plotë kontrolli për vlerësimin e pasurisë, dhe ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Gentian Medja, me shkresën nr. *******, datë 13.11.2017.

5. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, dhe të verifikonte nëse subjekti i rivlerësimit është i përshtatshëm për vazhdimin e ushtrimit të detyrës. Për këtë qëllim, ky institucion ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Gentian Medja, me shkresën nr. ******* prot., datë 27.10.2017 të DSIK-së, i deklasifikuar me vendimin nr. 8, datë 08.01.2018, të KDZH-së.

6. Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale bazuar në dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe në përfundim ka dërguar një raport për analizimin e aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, z. Gentian Medja, nr. *******, datë 15.02.2018

7. Me hedhjen e shortit, trupi gjykues administroi:

- Raportin e vlerësimit të pasurisë, sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016, të hartuar nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si “ILDKPKI”),
- Raportin e vlerësimit të figurës sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016 nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (më poshtë referuar si “DSIK”),
- Raportin e vlerësimit profesional sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (më poshtë referuar si “IKLD”).

8. Me vendimin nr. 1, datë 06.12.2017, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Gentian Medja, bazuar në vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe rivlerësimin e aftësisë profesionale, si dhe caktoi kryesuesin e trupës,

komisionerin Roland Ilia. Të gjithë anëtarët kanë deklaruar mosqënien në kushtet e konfliktit të interesit.

9. Me vendimin nr. 2, datë 29.03.2018, trupi gjykues vendosi të thellojë hetimin administrativ në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit z. Gentian Medja.

10. Me vendimin nr. 3, datë 03.04.2018, trupi gjykues vendosi të përzgjedhë në mënyrë rastësore 5 (pesë) çështje gjyqësore shtesë nga tabelat statistikore të paraqitura nga KLD, të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, të cilat iu dërguan për analizë Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në funksion të hetimit administrativ lidhur me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

11. Me vendimin nr. 4, datë 11.07.2018, trupi gjykues vendosi:

- Të përfundojë hetimin paraprak në lidhje me verifikimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe rivlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Gentian Medja;
- Të miratojë rezultatet paraprake të hetimit;
- Të njoftojë subjektin e rivlerësimit se provat e grumbulluara për të tri kriteret kanë nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 dhe atij i ka kaluar barra e provës mbi gjetjet lidhur me aftësite profesionale, duke i vënë në dispozicion rezultatet paraprake të hetimit, në bazë të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016;
- Të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative;
- Të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtën e aksesit në dosje, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarëve, si dhe afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

12. Në datën 23.07.2018, subjekti i rivlerësimit njoftoi në rrugë elektronike dhe vuri në dispozicion të Komisionit parashtesë me pretendimet e tij dhe dokumente shkresore, të cilat u administruan nga ana e trupit gjykues.

13. Me vendimin nr. 5, datë 24.07.2018, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Gentian Medja, në seancë dëgjimore publike në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 30.07.2018, ora 12:00, pranë Pallatit të Koncerteve (ish Pallati i Kongreseve), kati i 2-të, Tiranë.

14. Në datën 30.07.2018, ora 12:00, u zhvillua seanca dëgjimore publike sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: *“Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit dhe vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave”*, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Gentian Medja, bazuar në të tri komponentët, atë të vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësisë profesionale.

II. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI LIDHUR ME VLERËSIMIN E PASURISË

II.1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Nga aktet e ILDKPKI-së rezulton se subjekti ka dorëzuar rregullisht deklaratat e interesave private, nga viti 2004 deri në vitin 2016. Subjekti i rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar “Deklaratën e Pasurisë së Vlerësimit Kalimtar, Vetting” pranë ILDKPKI-së, në përputhje me nenin 32/1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.

Ky institucion ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, sipas neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, dhe ka konkluduar¹ se:

1. Deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;
2. Ka burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
3. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
4. Nuk ka kryer deklarim të rremë;
5. Subjekti nuk gjendet në situatë konflikti interesi.

II.2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të

¹ Shih raportin e dërguar me shkresën nr. 265/32, datë 13.11.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me pasuritë e subjektit Gentian Medja është kryer një proces i plotë hetimi administrativ, sipas dispozitave ligjore të Kreut VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në deklaratimet e subjektit pranë ILDKPKI-së, provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar pranë Komisionit, çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, si dhe komunikimet me subjektin sipas nenit 46 të këtij ligji dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

Hetimi paraprak administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë, konsistoi në :

- a. Verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur;
- b. Verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë;
- c. Evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive;
- ç. Evidentimin ose jo deklaratimeve të rremë;
- d. Nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim verifikimin nëse subjekti ka bërë deklaratime të pamjaftueshme për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

II.2/1 Lidhur me pasuritë në pronësi të subjektit

Gjatë hetimit administrativ është konstatuar se subjekti nuk ka deklaruar dhe nuk ka rezultuar që të ketë në pronësi pasuri të paluajtshme.

Lidhur me pasuritë e luajtshme, ky hetim është bazuar në:

1. Llogarinë e pagës si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në Tirana Bank, në numrin e llogarisë ***, në vlerë 1,039,748 lekë, në zotërim 100%, gjendja e llogarisë deri në datën 20.01.2017, deklaruar në Deklaratën Vetting.

Gjatë hetimit administrativ rezultoi se:

- ✓ Të ardhurat nga puna në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër janë deklaruar rregullisht nga subjekti ndër vite dhe në Deklaratën Vetting.

- ✓ Banka e Tiranës konfirmon² të ardhurat nga paga pranë kësaj gjykate (bashkangjitur 55 fletë *nxjerrje llogarie*).
- ✓ Nga verifikimi i dokumenteve ka rezultuar se subjekti ka deklaruar për disa vite të ardhura në vlerë më të mëdha se të ardhurat e dokumentuara në tabelën më poshtë:

		2004	2005	2006	2007	2008
Paga sipas deklarimit	Paga si gjyqtar në Gjykatën Shkodër	222,500	900,000	974,520	974,520	975,899
Paga sipas dokumenteve	Paga si gjyqtar në Gjykatën Shkodër	215,470	865,916	899,095	843,076	919,099
	Diferenca për çdo vit	7,030	34,084	75,425	131,444	56,800

Për këto mospërputhje në deklarime, është pyetur subjekti dhe ai është përgjigjur³, duke sqaruar se:

Lidhur me deklarin e të ardhurave nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër për vitin 2005, deklarimi i tij është i përafërt, pasi nuk ka pasur dokument shkresor për ta vërtetuar pagën. Për vitin 2006, 2007 dhe 2008, sqaron se bashkë me pagat ka deklaruar dhe dietat për shkak të delegimeve, ndërsa në vërtetimet e marra nga gjykata për këto vite nuk janë përfshirë këto dieta. Këtë e konfirmojnë dy vërtetimet bashkangjitur të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, sipas të cilave diferencat e krijuara krahasimisht me vërtetimet e lëshuara më parë janë nga mospërfshirja e dietave të përfituara gjatë këtyre viteve. Gjithashtu subjekti ka paraqitur llogaritë bankare për të vërtetuar këto të ardhura.

Duke marrë në konsideratë deklarinet e subjektit dhe dokumentet shkresore që ka paraqitur, rezultoi se të ardhurat e deklaruara janë përafërsisht të barabarta me ato të dokumentuara, (me diferencat të pakonsiderueshme) të pasqyruara si në tabelën më poshtë:

Vitet	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Dokumentet në "Vetting"	222,500	900,000	974,520	974,520	975,899	930,072
Dokumentet në pyetësor	222,500	872,238	975,240	974,869	950,899	930,072
Diferenca	0	27,762	-720	-349	25,000	0

² Shih shkresën nr. *** prot., datë 18.12.2017, në dosjen e Komisionit.

³ Shih përgjigjen e subjektit, të datës 10.05.2018, në dosjen e Komisionit.

2. Llogarinë e pagës si gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, në BKT, nr. i llogarisë ***, gjendja e llogarisë deri në datën 20.01.2017 në vlerë: 1,133,450.75 lekë, në zotërim 100%, deklaruar në Deklaratën Vetting.

Gjatë hetimit administrativ nga Komisioni, ka rezultuar se:

- ✓ Të ardhurat nga puna në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë janë deklaruar rregullisht nga subjekti ndër vite, edhe në Deklaratën Vetting.
- ✓ BKT konfirmon⁴ të ardhurat nga paga pranë kësaj gjykate. (bashkangjitur 55 fletë *nxjerrje llogarie*).

Për këtë llogari bankare nuk ka pasaktësi në deklarime dhe nuk ka pasur dyshime.

3. Autoveturën e markës “Mercedes-Benz”, tipi *** ***, me targë ***, me shasi ***, viti i prodhimit 1998, blerë sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.02.2009, me vlerë 250.000 lekë, krijuar nga paga si gjyqtar, deklaruar në Deklaratën Vetting.

Nga hetimi administrativ ka rezultuar se kjo pasuri është deklaruar në deklarinimin për vitin 2009 dhe në Deklaratën Vetting me burim të të ardhurave nga paga si gjyqtar.

- ✓ DSHPTRR-ja konfirmon⁵ se në emër të subjektit është e regjistruar autovetura me targë ***.
- ✓ Nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie.

Për këtë pasuri nuk ka pasaktësi në deklarime dhe nuk ka pasur dyshime.

4. Kursimet familjare ndër vite *cash*, në vlerën 1,400,000 lekë. Krijuar nga të ardhurat nga bashkëjetesa dhe kontributi i përbashkët me prindërit, ku subjekti zotëron 50%. Pjesa tjetër prej 50% është deklaruar në deklaratën vetting nga prindërit e tij në mënyrë të barabartë secili.

Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka dhënë shpjegime⁶ lidhur me gjendjet *cash* në shtëpi dhe likuiditetet në banka, në fund të çdo viti për periudhën 2004 - 2016, deklarime të cilat përputhen me deklarinimet ndër vite, dhe me shifrat e llogaritura gjatë analizës financiare. Gjithashtu, u vërtetua se likuiditetet në *cash* janë të justifikuara me burime financiare të ligjshme.

⁴ Shih shkresën nr. *** prot., datë 28.12.2017, në dosjen e Komisionit.

⁵ Shih shkresën nr. *** prot., datë 20.12.2017, në dosjen e Komisionit.

⁶ Shih përgjigjen e subjektit, të datës 28.05.2018, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 28.05.2018.

II.2/2 Personat e lidhur, babai Selahydin Medja dhe nëna Behije Medja, kanë deklaruar:

1. Apartament banimi me sipërfaqe 65 m² i ndodhur në Shkodër, i regjistruar në ZVRPP Shkodër me nr. pasurie ***. Blerë me kontratë privatizimi në vitin 1994 në vlerën 14,525 lekë, në bashkëpronësi të z. S. M (babai i subjektit), znj. B. M (nëna e subjektit) dhe znj. N.Medja (motra e subjektit), me burim krijimi të ardhurat nga paga dhe pensioni. Vlera e RVP 2,516,150 lekë, sipas rivlerësimit të ZVRPP-së Shkodër, datë 24.01.2012, deklaruar në Deklaratën Vetting.

Nga hetimi administrativ ka rezultuar se:

- Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti në deklaratën për vitin 2003 dhe në Deklaratën Vetting, me burim krijimi të ardhura nga paga dhe pensionet e prindërve.
- ZVRRPP-së Shkodër⁷ konfirmon se shtetasit S.M dhe B.M janë bashkëpronarë me nga 1/3-tën pjesë secili mbi pasurinë me nr. ***, duke vënë në dispozicion kontratë shitblerjeje, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.12.1994, certifikatë e pronësisë dhe kartelë pasurie me datë lëshimi 31.01.2012. Vlera e RVP-së është 2,516,150 lekë.
- Për këtë pasuri nuk ka pasaktësi në deklarime dhe nuk ka pasur dyshime. Është e justifikuar me burime të ligjshme.

2. 72 (shtatëdhjetë e dy) aksione në emër të babait të subjektit, z. S.M (100 %), 72 (shtatëdhjetë e dy) aksione në emër të nënës së subjektit, znj. B.M (100 %) , në shoqërinë “***” sh.a., Shkodër, krijuar me bono privatizimi, në vlerën 75,000 lekë bono privatizimi secili, deklaruar për vetting nga subjekti dhe prindërit.

Nga hetimi administrativ ka rezultuar se:

- ✓ Vërtetohet⁸ se z. S.M dhe znj. B.M kanë aplikuar për blerjen e 72 aksioneve pranë “***” sh.a., në vitin 2015.
- ✓ QKB-ja⁹, bashkëngjitur ekstraktit historik të regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “***” sh.a., vërteton se S.M dhe B.M janë aksionerë në këtë shoqëri me 0.032 % të kuotave (nr. i aksioneve me të drejtë vote: 75,000).
- ✓ Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër¹⁰ vërteton se, përveç vitit 2015, kur fitimi i kësaj shoqërie ka qenë 969,794 lekë, kjo shoqëri figuron me humbje dhe se subjekti “***” sh.a., me NIPT ***, nuk ka deklaruar tërheqje dividendi.

⁷ Shih shkresat nr. *** prot., datë 22.09.2017 dhe nr. *** , datë 24.08.2017 të ZVRPP Shkodër, në dosjen e ILDKPKI-së dhe Komisionit.

⁸ Shih formularin e kërkesave për blerje aksionesh nr. *** , në dosjen e ILDKPKI-së.

⁹ Shih shkresën nr. *** , datë 05.07.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁰ Shih shkresën nr. *** , datë 28.06.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

- ✓ Nga analiza financiare rezulton se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur të ardhura nga aksionet që z. S.M dhe znj. B.M kanë në pronësi në shoqërinë “***” sh.a., Shkodër.

Për këtë pasuri, nuk ka pasaktësi në deklarime dhe nuk ka pasur dyshime.

II.2/3 Detyrime financiare të subjektit

Shpenzime të subjektit për kontratën e qirasë së banesës në Rr. “***” pall. ***, Kulla ***, ***, Tiranë për periudhën 01.02.2017, deri në datë 31.12.2017. Shuma totale vjetore e detyrimit financiar është 101,750 lekë.

Nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar se:

- ✓ Ky detyrim është deklaruar në deklaratën për vetting;
- ✓ Me kontratën e qirasë të lidhur pa akt notarial në datën 25.11.2016, midis qiradhënësit Gj. Sh dhe qiramarrësve G.M dhe F.M, vërtetohet se pjesa takuese e detyrimit mujor të subjektit është 9,250 lekë.

Nuk ka pasur pasaktësi në deklarime si dhe dyshime lidhur me këtë detyrim ligjor. Subjekti ka pasur mundësi financiare për pagimin e detyrimit.

II. 2/4 Analizë financiare

Analiza financiare¹¹ e kryer gjatë hetimit administrativ, është bërë mbi përlllogaritjen e të ardhurave, shpenzimeve dhe vlerave të pasurive për subjektin dhe personat e lidhur me të, bazuar në deklaratimet periodike të subjektit të rivlerësimit, dhe dokumentet e administruara nga Komisioni, me qëllim evidentimin e pasurive të pajustificuara me burime të ligjshme.

Nga kjo analizë, e përmbledhur si në tabelën më poshtë, ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë e vënë në vite, si dhe shpenzimet e jetesës.

	Subjekti	Babai	Nëna	TOTAL
Total ardhura	12,986,982	2,482,644	887,682	16,357,308
Total shpenzime	-1,772,526	-2,482,644	-887,682	-5,142,852

¹¹ Shih analizën financiare për dosjen nr. *** në dosjen e Komisionit.

Total asete likuiditete	3,793,067		3,793,067
Diferenca për shpenzime të tjera	7,421,389		7,421,389
Shpenzime të tjera/vit	570,876		570,876
Shpenzime të tjera/muaj	47,573		47,573

Metodologjia e përdorur nga Komisioni, për analizën financiare:

Për analizën financiare, ky relacion është mbështetur në:

1. Gjendjen e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga Tirana Bank¹² dhe BKT¹³, si dhe gjendjet *cash* të deklaruara nga subjekti¹⁴.
2. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:
 - (i) Të ardhurat nga pagat e subjektit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër¹⁵; të ardhurat nga pagat e subjektit në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë Tiranë¹⁶; të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës¹⁷; të ardhura nga puna si pedagog në shkollën private të arsimit të lartë “Gjon Buzuku”¹⁸ dhe Universitetin “Luigj Gurakuqi”¹⁹;
 - (ii) Të ardhura e prindërve të subjektit²⁰.
3. Shpenzimet, ku përfshihen:
 - (i) Shpenzimet e jetesës bazuar në llogaritjet e ILDKPKI-së sipas INSTAT²¹;
 - (ii) Shpenzime udhëtimi për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi TIMS²². Për përllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit janë marrë si bazë shpenzimet mesatare të udhëtimeve sipas linjave ajrore, duke filluar nga 180 euro për udhëtim për linjat *low cost* deri në 300 euro për udhëtim për linjat më të gjata. Ndërsa për udhëtimet në rrugë tokësore është llogaritur 50 euro për udhëtim në rastet kur ka qëndruar më shumë se një ditë. Ndërsa për shpenzimet e qëndrimit janë llogaritur 50 euro/ditë shpenzim qëndrimi dhe ushqimi.
 - (iii) Shpenzime qiraje për apartamentin në Tiranë²³;

¹² Shih shkresën nr. *** prot., datë 18.12.2017, në dosjen e Komisionit.

¹³ Shih shkresën *** prot., datë 27.12.2017, në dosjen e Komisionit.

¹⁴ Shih deklaratimet periodike të çdo viti, në dosjen e ILDKPKI-së dhe deklaratën vetting 2017 në dosjen e Komisionit.

¹⁵ Shih vërtetimin (pa date) në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁶ Shih vërtetimin nr. *** prot./ 01.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁷ Shih vërtetimin nr. *** prot., datë 26.10.2016, në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁸ Shih vërtetimin e datës 24.10.2016, në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁹ Shih vërtetimin nr. *** prot., datë 24.10.2016 në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁰ Shih shkresën nr. *** prot., datë 26.10.2016, në dosjen e ILDKPKI-së.

²¹ Shih raportin e ILDKPKI-së në dosjen e Komisionit si dhe shkresën nr. *** datë 18.12.2017.

²² Shih shkresën nr. *** prot., datë 20.12.2017, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si dhe të dhënat e nxjerra nga sistemi TIMS në dosjen e Komisionit.

²³ Shih deklaratimet periodike 2014 - 2016 dhe kontratën e qirasë në dosjen e ILDKPKI-së dhe Deklaratën Vetting 2017 në dosjen e Komisionit, e njëjtë me kontratën e qirasë të paraqitur gjatë komunikimit me subjektin.

4. Në vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e shitblerjeve të këtyre pasurive.²⁴

II.2/5. Rezultatet përfundimtare në lidhje me rivlerësimin e pasurive

Në përfundim të hetimit administrativ lidhur me rivlerësimin e pasurisë, referuar pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit z. Gentian Medja, nuk kanë rezultuar pasaktësi në deklarime, nuk kanë rezultuar likuiditete të pajustificuara, nuk kanë rezultuar deklarime të rreme apo fshehje pasurie nga ana e tij.

III. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI LIDHUR ME VLERËSIMIN E FIGURËS

Institucioni kompetent për kontrollin e figurës, verifikimit të deklarimeve të subjektit dhe të dhënave të tjera, me qëllim përcaktimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me krimin e organizuar, DSIK-ja, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999, i ndryshuar, pasi ka kryer të gjitha procedurat për kontrollin në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 4 dhe nenin 37 dhe 38 të ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur pranë Komisionit raportin përfundimtar me nr. *** prot., datë 27.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së, nr. 8, datë 08.01.2018, ku rezulton se:

- Formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në përputhje me ligjin nr. 84/2016.
- Subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njejtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës.
- Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose persona të dyshuar të krimit të organizuar.
- Konstatohet se është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

Gjatë procesit të rivlerësimit, nuk ka pasur të dhëna, si dhe nuk janë krijuar dyshime nga Komisioni për pastërtinë e figurës së subjektit të rivlerësimit Gentian Medja.

²⁴ Shih kontratat e blerjes së pasurisë së paluajtshme bashkëngjitur shkresës së ZVRPP-së Shkodër, me nr. *** prot., datë 22.9.2017, në dosjen e ILDKPKI-së, si dhe kontratën e blerjes së automjetit bashkëngjitur shkresës së DPSHTRR-së Tiranë, me nr. *** prot., datë 22.12.2017, në dosjen e Komisionit.

IV. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI LIDHUR ME VLERËSIMIN E AFTËSISË PROFESIONALE

Organi kompetent për vlerësimin e aftësive profesionale, Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, z. Gentian Medja, sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, dhe ka paraqitur raportin me nr. *** prot., datë 15.02.2018.

Gjithashtu, pas kërimit nga Komisioni, ky institucion ka përgatitur raportin nr. ***, datë 23.04.2018, për analizimin e pesë dosjeve shtesë të caktuara për shqyrtim, me vendimin nr. 3, datë 03.04.2018 të trupit gjykues.

Sipas detyrimit të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, nga ana e relatores së çështjes është bërë rivlerësimi i aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, z. Gentian Medja, mbështetur në:

1. Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Inspektorati i KLD-së, sipas procedurave ligjore të parashikuara nga neni 43 i ligjit nr. 84/2016, i cili është bazuar në:

A. Formularin e vetëdeklarimit.

Nga analiza që Inspektorati i KLD-së i ka bërë dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, konstatohet:

Saktësia e formularit të vetëdeklarimit:

Formulari është plotësuar sipas shtojcës së ligjit, rubrikat janë plotësuar me saktësi, me shkrim të qartë e të lexueshëm dhe formulari është nënshkruar rregullisht në çdo faqe.

Përvoja profesionale në 10 vitet e fundit:

Subjekti ka deklaruar se në periudhën shtator 2004 - nëntor 2013 ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe nga nëntori deri tani ushtron detyrën e gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Subjekti ka deklaruar se ka ushtruar në vitet 2005 - 2010 dhe 2012 - 2014 detyrën e pedagogut në Universitetin e Shkodrës.

Detyrat e kryera 3 vitet e fundit dhe të dhënat statistikore:

Subjekti ka deklaruar se në vitin 2014 i janë caktuar 622 çështje themeli, 116 urdhra ekzekutimi dhe 9 kërkesa. Subjekti ka përfunduar 547 çështje themeli, 110 urdhra ekzekutimi dhe 8 kërkesa. Në vitin 2015, i janë caktuar 444 çështje themeli, 137 urdhra ekzekutimi dhe 49 kërkesa. Subjekti ka përfunduar 443 çështje themeli, 142 urdhra ekzekutimi dhe 43 kërkesa. Në vitin 2016 i janë caktuar 446 çështje themeli, 162 urdhra ekzekutimi dhe 52 kërkesa. Subjekti ka përfunduar 343 çështje themeli, 161 urdhra ekzekutimi dhe 55 kërkesa.

Trajnimet në 3 vitet e fundit:

Subjekti ka deklaruar se ka qenë pjesëmarrës në 15 aktivitete trajnuese të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, në fushat e falimentimit, zbatimit të sistemit të drejtësisë, koncesioneve, gjykimit administrativ, fazat e ekzekutimit të procesit gjyqësor administrativ, të drejtës administrative, kodit administrativ, të drejtës procedurale administrative, etj. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar dhe 3 trajnime jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës.

B. Tri vendimet e përzgjedhura nga subjekti:

Vendimi nr. 5186, datë 29.9.2014; vendimi nr. 5126(3405), datë 14.10.2015 dhe vendimi nr. 4728(4743), datë 13.10.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

C. Dokumente të tjera të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit:

Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe dokumente të tjera lidhur me të dhënat personale, diplomimin, mësimdhënien në universitet dhe 17 certifikata për pjesëmarrjen në trajnime për periudhën 2003 - 2013.

D. Raporti i 5 dosjeve të subjektit të përzgjedhura me short:

Çështja administrative nr. 31025-03012-80-2015 regj., datë 07.05.2015; çështja administrative nr. 31104-07409-80-2016 regj., datë 21.09.2016; çështja administrative nr. 31004-03331-80-2016 regj, datë 26.04.2016; çështja administrative nr. 6145 regj., datë 24.6.2014; çështja administrative nr. 787 regj., datë 13.01.2014 .

E. Të dhëna nga burime arkivore të KLD-së:

Për subjektin e rivlerësimit gjatë periudhës 3-vjeçare të rivlerësimit, tetor 2013-tetor 2016, janë paraqitur gjithsej 8 ankesa në Inspektoratin e KLD-së. Nga këto 4 ankesa janë arkivuar me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen nëpërmjet apelimit gjyqësor dhe pasi janë analizuar katër ankesat, rezultoi se:

- 3 ankesa të vitit 2014 janë arkivuar, pasi pretendimet kanë qenë të pabazuara.
- 1 ankesë e vitit 2016 i është regjistruar gjyqtarit për vlerësim profesional dhe etik, pasi është konstatuar vonesë në gjykim të çështjes administrative.

Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për subjektin e rivlerësimit, përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Konkluzionet e KLD-së:

a. Lidhur me aftësitë profesionale:

✓ Njohuritë ligjore

Subjekti ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në dosjet e vëzhguara, subjekti identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit. Subjekti njeh dhe zbaton parimet procedurale gjatë gjykimit, analizon nga pikëpamja ligjore aktin administrativ dhe arsyeton duke dhënë argumente të sakta ligjore. Subjekti ka njohuri në të drejtën administrative, legjislacioni i prokurimit publik, e drejta procedurale administrative, etj.

✓ Arsyetimi ligjor

Është konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet përfundimtare të arsyetuara prej tij janë të qarta dhe të kuptueshme. Subjekti respekton rregullat e shkrimit të tekstit në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit. Përmbajtja e vendimit është e plotë dhe u jep përgjigje pretendimeve të palëve. Subjekti i kushton rëndësi analizës së normës ligjore dhe respektimit të standardit të procesit të rregullt ligjor. Subjekti u kushton rëndësi dhe vendimeve të ndërmjetme.

b. Lidhur me aftësitë organizative

✓ Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 - 08.10.2016, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit dhe kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Subjekti ka deklaruar se në këtë periudhë i janë caktuar për gjykim 1572 çështje themeli dhe ka përfunduar 1367 çështje. Rendimenti i përfundimit të çështjeve është 86.95%. Gjithashtu, i janë caktuar urdhra ekzekutimi dhe 106 kërkesa, me rendiment 99%. Sipas të dhënave statistikore të gjykatës, për periudhën e rivlerësimit, subjekti ka përfunduar gjithsej 1829 çështje. Subjekti ka pasur ngarkesë sasiore të lartë, pothuajse trefishin e standardit minimal. Kohëzgjatja e gjykimeve ka qenë në intervale kohore nga 4 ditë deri në 2 muaj e 26 ditë. Nga 5 dosjet e vëzhguara, në 3 raste është respektuar afati ligjor, standard i gjykimit dhe në 2 raste nuk është respektuar. Subjekti i ka kushtuar rëndësi arsyetimit në kohë të vendimeve gjyqësore. Subjekti i rivlerësimit është eficient dhe efektiv, respekton kohën në gjykim dhe gjykimet kanë përfunduar brenda afateve të arsyeshme.

✓ Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore, ku përgjithësisht të 14 seancat kanë qenë produktive. Subjekti respekton afatin ligjor 7 - ditor për vënien në lëvizje të dosjes dhe kryen me korrektësi veprimet përgatitore. Subjekti u kushton rëndësi veprimeve përgatitore dhe përfundon gjykimin me 1-2 seanca, si dhe dokumentimit të veprimeve të kryera dhe urdhrave të ndërmjetëm për kërkesat e palëve. Është konstatuar vetëm një rast ku vendimi i dhënë nga subjekti i

rivlerësimit është cenuar dhe çështja është kthyer për rigjykim, për shkak të formimit të pasaktë të ndërgjyqësisë.

✓ Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të përzgjedhura me short nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale dhe radhitja e dosjeve nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe përdorimin e tyre. Dosjet gjyqësore janë inventarizuar.

c. Lidhur me etikën dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

✓ Etika në punë

Subjekti i rivlerësimit ka marrë titullin jurist nga universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër në vitin 2001 dhe titullin “Magjistrat, gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2005. Pas studimeve është emëruar gjyqtar dhe më pas kryetar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe nga nëntori 2013 gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, i procedimeve disiplinore dhe dosjet e vëzhguara, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të subjektit.

✓ Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

✓ Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit. Në 5 dosjet e vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtim të tij nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhen me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo pakicave dhe nuk është konstatuar përdorimi i gjuhës diskriminuese, apo elementeve të tjera, që vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Nuk është konstatuar që subjekti të këtë cenuar të drejtat e palëve dhe që subjekti nuk ka respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme.

d. Lidhur me aftësitë personale dhe angazhimin profesional

✓ Aftësia e komunikimit

Në 5 dosjet e vëzhguara në procesverbalin gjyqësor, subjekti komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse. Subjekti ka aftësi komunikuese me palët, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe duke respektuar barazinë e palëve. Nga dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale dhe komunikimi në përputhje me etikën dhe i qartë.

✓ Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhënat specifike mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Bashkëpunimi me administratën ka qenë në nivelin e duhur, pasi nuk janë konstatuar vonesa në fillimin e seancave, dështim të tyre apo vonesa në arsyetimin e vendimeve.

✓ Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti nuk ka pasur detyrimin për t'iu nënshtuar formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Subjekti ka deklaruar se ka marrë pjesë në 15 seminare të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës dhe lënda e trajnimeve ka lidhje me detyrën e gjyqtarit. Subjekti ka marrë pjesë edhe në 2 seminare jashtë programit, që lidhen me të drejtat e emigrantëve dhe të drejtën e autorit. Subjekti, në vitet 2005 – 2014, është angazhuar dhe në veprimtari akademike, në detyrën e pedagogut në universitet.

Në përfundim, Inspektorati i KLD-së, pasi ka evidentuar disa të meta, duke i përmendur dhe analizuar ato rast pas rasti, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi profesionale, ka aftësi organizative, ka etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale.

2.Vlerësimi i informacionit të marrë nga burime të ligjshme. Si i tillë është konsideruar:

A. Informacioni i marrë nga denoncimet, si vijon:

Për subjektin e rivlerësimit ka dy denoncime që përmbushin kriteret e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016:

1. Denoncimi me nr. *** prot., datë 07.03.2018, i denoncuesit R.B, bashkangjitur të cilit është vendimi gjyqësor nr. 1642 (80-2016-1646), datë 05.04.2016, i dhënë nga Gjykata Administrative e Shkallës së parë Tiranë.
2. Denoncimi me nr. *** prot., datë 18.05.2018, i denoncuesit V.D, bashkangjitur të cilit nuk ka asnjë dokument shkresor, i cili denoncon katër gjyqtarë për aftësi profesionale, midis të cilëve dhe subjektin e rivlerësimit, pa fakte e rrethana konkrete.

Gjatë procesit të rivlerësimit nga Komisioni, është bërë analiza e vendimit nr. 1642 (80-2016-1646), datë 5.04.2016, të dhënë nga subjekti z. Gentian Medja, nga ku ka rezultuar se:

Me këtë vendim është vendosur pranimi pjesërisht i kërkesë padisë së denoncuesit Riza Bajrami. Vendimi është ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë dhe pritet të shqyrtohet nga kjo gjykatë.

Subjekti i rivlerësimit ka shqyrtuar çështjen administrative me nr. regj. them. 6913/450 (7282), me palë paditëse: R.B dhe të paditur: ZVRPP-së dhe ZQRPP-së Tiranë. Objekti i kërkesë padisë ishte “Detyrimin e palës së paditur të bëjë korrigjimin e gabimit material, teknik hartografik në hartën ZK *** në pasqyrimin e të dhënave për sipërfaqen e pronës prej 46 m²....”. Çështja ka datën e regjistrimit themeltar 13.11.2015 dhe vendimi është dhënë më datë 05.04.2016.

Vendimi përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës. Në pjesën hyrëse nuk pëcaktohet se sa seanca janë zhvilluar për këtë çështje. Pjesa arsyetuese është e plotë ku përcaktohen qëndrimet e palëve, paraqitja e provave, analiza e tyre dhe konkluzioni duke u bazuar në fakte dhe prova. Këtu është arsyetuar nga subjekti Gentian Medja, se çështja objekt gjykimi duhet të ndahet në 2 pjesë dhe duhet pranuar vetëm pjesa e cila është në juridiksionin e gjykatës administrative ndërsa pjesa tjetër duhet të shqyrtohet dhe zgjidhet nga gjykata si çështje dhe mosmarrëveshje civile. Në vendim, subjekti është bazuar në vendimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë duke përmendur dhe cituar vendimin unifikues të kësaj gjykate nr. 4, datë 10.12.2013, sipas të cilit “Kur nga objekti dhe shkak ligjor i padisë, mosmarrëveshja objekt gjykimi rezulton e natyrës civile dhe si rezultat i zgjidhjes së pasojave të çështjes me natyrë civile mund të urdhërohet kryerja e disa veprimeve administrative, si p.sh., urdhërimi i ZVRPP-së, për të kryer fshirjen apo regjistrimin e një prone të caktuar, atëherë shqyrtimi i këtyre çështjeve do të jetë në kompetencën e gjykatës që shqyrton mosmarrëveshjet civile”. Vendimi është hartuar në paragrafë të cilët lehtësojnë kuptimin e arsytimit të vendimit dhe janë respektuar rregullat drejtshkrimore. Vendimi është i arsyetuar me një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme. Dispozitivi i vendimit ka përcaktuar pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë, bazën ligjore, duke detyruar palët për zbatimin e këtij detyrimi dhe ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë për pjesën tjetër. Dispozitivi ka përcaktuar të drejtën dhe afatin e ankimit kundër këtij vendimi.

B. Informacioni lidhur me një kallëzim penal për subjektin e rivlerësimit, si vijon:

Me shkresën nr. ***prot., datë 13.02.2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, rezulton se denoncuesi i sipërpërmendur R.B, ka bërë kallëzim penal në adresë të subjektit, duke iu referuar po këtij vendimi, (nr.1642 (80-2016-1646) datë 5.04.2016), me pretendimin se subjekti ka vepruar në kundërshtim me provat dhe me ligjin duke shpërdoruar detyrën e ngarkuar me ligj. Për këtë shkak, rezulton se ndaj subjektit të rivlerësimit Gentian Medja, është regjistruar materiali hetimor, nr. ***, datë 19.05.2016, për veprën penale “shpërdorim i detyrës”. Gjatë procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, është analizuar

materiali i fashikullit të dosjes për mosfillim procedimi me nr. 1328 në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, nga ku ka rezultuar se:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, pasi ka administruar kërkesën e kallëzuesit, ka filluar procedimin hetimor në ngarkim të subjektit, pasi ka tërhequr dosjen gjyqësore që i përket vendimit nr. 1642 (80-2016-1664), datë 05.04.2016, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, ka vendosur kqyrjen dhe marrjen e provave shkresore, ka mbajtur korrespondencë me ZVRPP-në Tiranë, ka thirrur dhe pyetur kallëzuesin, dhe në fund të hetimeve prokurori i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, më datë 17.06.2016, ka vendosur mosfillimin e çështjes penale ndaj subjektit të rivlerësimit Gentian Medja.

Organi i akuzës, ka konkluduar se gjyqtari Gentian Medja, nuk ka kryer veprime apo mosveprime që vijnë në kundërshtim me ligjin që përbëjnë mospërbushje të rregullt të detyrës si dhe fakti i vërtetuar me të gjitha provat nuk përbën veprën penale “Shpërdorim i detyrës” të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Nga verifikimet e kryera, nuk rezultuan të dhëna që gjyqtari është ndikuar nga interesa të kundraligjshme ose për shkaqe të dobëta, etj. Marrja e vendimit të datës 05.04.2016 është kompetencë e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe si i tillë nuk përbën elemente të veprës penale “shpërdorim i detyrës”, pasi ai është marrë në përputhje me kërkesat e ligjit, provat e marra dhe administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe bindjes së brendshme të krijuar mbi bazën e tyre.

Prokuroria ka theksuar se nëse kallëzuesi nuk është dakord me vendimin e gjyqtarit Gentian Medja atëherë ai mund të paraqesë ankim në Gjykatën e Apelit, siç dhe ka vepruar në fakt dhe kallëzuesi dhe çështja aktualisht është në shqyrtim gjyqësor.

Kundër vendimit të mosfillimit kallëzuesi R.B, ka bërë ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës e cila me vendimin nr. 343, datë 27.07.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesës (ankimit), si të pabazuar në prova dhe në ligj duke lënë në fuqi vendimin e prokurorisë për mosfillim të çështjes penale për subjektin e rivlerësimit.

C. Informacioni i marrë nga ankesa e subjektit G.B, i cili ankohet lidhur me dhënien vendimit nr. 745 (771), datë 01.03.2018, nga subjekti i rivlerësimit, me cilësinë e gjyqtarit të vetëm të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si vijon:

Nga përmbajtja e ankimit rezulton se ankuesi G.B ka kërkuar pranë Gjykatës Administrative Tiranë :

- Shfuqizimin e vendimit nr. ***, datë 28.10.2016, të KLD-së;

- Shfuqizimin e vendimit nr. ***, datë 28.10.2016, të KLD-së, për inspektimin nga Inspektorati i KLD-së;

- Shfuqizimin e vendimit nr. ***, datë 28.10.2016, të KLD-së; Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhërit nr. ***, datë 02.11.2016 për ndarjen e detyrave të inspektorëve të KLD-së;

- Detyrimin e organit administrativ të kryejë veprim administrativ, me qëllim revokimin e vendimit nr.102 të KLD-së, për shkak të rënies së shkakut të pezullimit;
- Detyrimin e KLD-së të kompensojë paditësin nga dtata 28.10.2017, deri në kthimin ne detyrë.

Subjekti i rivlerësimit, nga momenti i caktimit të çështjes ka ndjekur hapat proceduralë dhe në përfundim të hetimit gjyqësor me vendimin nr. 745 (771), datë 01.03.2018, ka vendosur :

- Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë;
- Detyrimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që t'i paguajë paditësit G.B pagën si gjyqtar nga data 28.10.2016, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar në lidhje me hetimin administrativ të nisur ndaj tij;
- Rrëzimin e kërkesëpadisë për pjesën tjetër të objektit të saj.

Gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioni i është drejtuar Inspektoratit të KLD-së që të marrë në analizë ankimin e sipërpërmendur, dhe në përgjigje²⁵ ky institucion ka dërguar raportin e vlerësimit dhe kopjen e dosjes gjyqësore.

Sipas raportit të KLD-së, ankesa e bërë nuk përmbush kriterin e bazueshmërisë për pranueshmëri sipas parashikimit të nenit 120 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu KLD konfirmon se:

- ✓ Subjekti ankues G.B , ka bërë ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë e cila ka kompetencën ligjore të verifikojë ligjshmërinë e vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, z. Gentian Medja.
- ✓ Për subjektin e rivlerësimit nuk janë konstatuar shkelje disiplinore gjatë veprimtarisë së tij gjatë procesit gjyqësor për dhënien e vendimit nr. 745 (771), datë 01.03.2018, dhe për këtë shkak është çmuar arkivimi i ankesës.

Bazuar në konkluzionet e KLD-së, dhe në vlerësimin tërësor të rrethanave, Komisioni vlerësoi se në ankesën e shtetasit G.B, nuk ka të dhëna që cenojnë etikën në punë apo aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

D. Informacioni i marrë nga 5 (pesë) dosjet e përzgjedhura me shortin e datës 15.11.2017, (pjesë e dosjes së KLD), tre vendimet e përzgjedhura nga subjekti (pjesë e dosjes së KLD) si dhe pesë çështjet shtesë të caktuara nga Komisioni, me vendim nr.3, datë 03.04.2018, të trupit gjykues

²⁵ Shih shkresën nr. *** , datë 22.6.2018, në dosjen e KPK.

✓ Pesë dosjet e përzgjedhura me short:

Çështja 1. Padiës: Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, i paditur: “***” sh.p.k.

Çështja 2. Çështja e regjistruar në datë 21.09.2016 me objekt konstatim i pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ dhe marrjen e masës së sigurimit të pezullimit të aktit administrativ.

Çështja 3. Padiëse: T.M, e paditur: Bashkia e Kurbinit.

Çështja 4. Padiës: F.C, e paditur: Drejtoria e Policisë e Qarkut Tiranë.

Çështja 5. Padiës: Q.Z, e paditur: Qendra Ndërinstitucionale Detare Durrës.

✓ Tre vendimet e përzgjedhura nga subjekti :

Çështja 1: Çështja e parë e përzgjedhur nga subjekti është me palë padiëse shoqëria “***” sh.p.k. Sipas raportit të KLD-së, çështja e parë e përzgjedhur nga ana e subjektit të rivlerësimit është si vijon: Padiës: ***, i paditur: Komisioni i Prokurimit Publik etj.

Çështja 2: Padiës: A.Z, i paditur: Universiteti i Mjekësisë Tiranë, e të tjerë.

Çështja 3: Padiës: Shoqëria “***” sh.p.k., e të tjerë, i Paditur: Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) dhe të tjerë.

✓ Pesë dosjet shtesë të caktuara për shqyrtim nga ana e Komisionit me vendimin nr. 3, datë 03.04.2018:

- Çështja 1: nr. akti ***, datë 21.05.2014, që i përket padiësve: N.H, etj., kundër të paditurit: Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, me objekt: “Deklarim i pavlefshmërisë absolute të tabelës përmbledhëse.....”.

- Çështja 2: nr. akti ***, datë 30.12.2015, që i përket padiësit: P.N kundër: ILDKPKI, me objekt: “Shfuqizimin e vendimit nr. ***, datë 02.10.2015 të ILDKPKI-së”, e përfunduar me vendimin nr. *** datë 29.12.2015.

- Çështja 3: nr. akti ***, datë 21.5.2015, që i përket padiësit: B.B kundër të paditurit: Dega e Tatim Taksave Elbasan, me objekt: “Kundërshtim i masës administrative nr. ***, datë 30.10.2010”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 27.07.2015.

- Çështja 4: nr. akti ***, datë 17.05.2016, që i përket padiësit: E.M, kundër të paditurit: Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor, dega rajonale Tiranë, me objekt: “Anullimin e aktit administrativ me gjobë nr. 56, datë 18.02.2016”.

- Çështja 5: nr. *** akti, datë 15.09.2014, që i përket paditësit: A.B kundër të paditurit: INUK, me objekt: “Shfuqizim akti”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 19.12.2014.

Pas analizimit të 13 (trembëdhjetë) çështjeve të sipërpërmendura, për subjektin e rivlerësimit kanë rezultuar gjetjet si vijojnë:

- Mosrespektim i përgjithshëm i afateve në gjykimin e çështjeve nga ana e subjektit të rivlerësimit, të parashikuara nga ligji për Gjykatat Administrative;
- Përgjithësisht mungojnë veprimet për thirrjen apo shtyrjen e seancave përgatitore dhe seancave gjyqësore pasi nuk janë lëshuar vendime të ndërmjetme apo urdhra nga ana e gjyqtarit, mungojnë procesverbale të mbajtura nga sekretaria gjyqësore;
- Ka parregullsi gjatë veprimeve përgatitore në mënyren e njoftimit të palëve, etj;
- Në disa raste është shënuar në mënyrë të pasaktë referenca e dispozitave ligjore.

E. Gjatë procesit të rivlerësimit profesional, janë kryer disa veprime në thellim të hetimit administrativ lidhur me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

Konkretisht, Komisioni ka këkuar informacion lidhur me:

1. Kërkesë për procedim disiplinor si dhe propozimet për marrjen e një mase disiplinore nga KLD²⁶. KLD ka konfirmuar se për subjektin nuk rezulton të jetë marrë masë disiplinore apo të jetë propozuar marrja e një mase të tillë nga ana e Ministrisë së Drejtësisë.

2. Kërkesë për ngarkesën në punë të subjektit për vitet 2014, 2015 dhe 2016, për çështjet e caktuara për gjykim dhe ato të përfunduara. KLD²⁷ konfirmon se numri i çështjeve të caktuara për gjykim është 2094 dhe numri i çështjeve me vendim është 1864.

3. Kërkesë për ngarkesën e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për këto vite, me qëllim që të bëhet krahasimi i ngarkesës së subjektit me gjyqtarët e tjerë. KLD²⁸ ka dërguar informacion për të gjithë gjyqtarët nga ku rezulton se subjekti është në tetë gjyqtarët me ngarkesën më të lartë në punë, me mbi 1800 çështje të përfunduara. Tetë gjyqtarët e tjerë kanë ngarkesë më të ulët, nga 600-1700 çështje.

4. Kërkesë për sqarime në lidhje me mospërputhjen e raportit të KLD-së nr. 300413, datë 15.02.2018, me të dhënat e deklaruara nga subjekti në formularin e vetëvlerësimit profesional, datë 26.01.2017, (pika1) gjatë përshkrimit të objektit të padisë dhe palëve ndërgjyqëse, në çështjen që i përket vendimit nr. 5186, datë 29.09.2014, i cili është një nga vendimet e

²⁶ Shih shkresën nr. ***, datë 29.01.2018, në dosjen e KPK.

²⁷ Shih shkresën nr. ***, datë 01.01.2018, në dosjen e KPK.

²⁸ Shih shkresën nr. ***, datë 01.01.2018, në dosjen e KPK.

përzgjedhura nga subjekti. KLD²⁹ ka dhënë sqarime lidhur me këtë, duke konfirmuar se është një lapsus nga ana e subjektit gjatë mbushjes së formularit të vetëdeklarimit, ku ka pasaktësi përsa i takon palëve, objektit dhe bazës ligjore, por të dhënat dhe ekstremitetet e tjera të vendimit janë të sakta, gjë që nuk ka sjellë asnjë pasojë.

5. Kërkesë për sqarime lidhur me faktin se në një rast figurojnë 1829 çështje të gjykuara (shkresa gjykatës administrative me nr. *******, datë 13.01.2017 dhe në një rast tjetër 1829 çështje të përfunduara (formatet tabelare për statistikën dhe raportin nr. *******, datë 15.02.2018). KLD³⁰ ka dhënë sqarime lidhur me çështjet e gjykuara dhe të përfunduara nga subjekti, duke konfirmuar se termi “çështje e gjykuar” është i njëjtë me termin “çështje e përfunduar”.

6. Kërkesë për shpjegime në lidhje me faktin që në statistikën për subjektin e rivlerësimit, ka mospërputhje në numrin e çështjeve të përfunduara (në një rast numri i çështjeve të përfunduara nga subjekti ka qenë 1829 dhe në një rast ka qenë 1852) sipas të dhënave të marra nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. KLD³¹ ka vënë në dispozicion një statistikë të re ku rezultojnë 9 çështje me palë kundërshtare dhe 26 çështje pa palë kundërshtare më shumë se në statistikën që është përdorur në procedurën e shortit për subjektin e rivlerësimit. Janë dhënë shpjegime nga kancelari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lidhur me mospërputhjet në shifra.

7. Kërkesë për shpjegime lidhur me faktin se përse gjatë analizës së tre vendimeve të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, nga ana e KLD-së, janë marrë në konsideratë vetëm vendimet dhe jo dosjet gjyqësore. KLD³² ka dhënë sqarime lidhur me tre çështjet e përzgjedhura nga subjekti gjatë vlerësimit profesional, dhe bazën ligjore ku inspektorati i KLD-së është mbështetur, duke marrë në konsideratë vetëm vendimet e përzgjedhura dhe jo dosjet e çështjeve gjyqësore, një praktikë e ndjekur për të gjithë subjektet e rivlerësimit.

8. Kërkesë për analizimin e pesë çështjeve shtesë të gjykuara nga subjekti, të përzgjedhura në mënyrë rastësore nga trupi gjykues, sipas vendimit nr. 3, datë 03.04.2018, me qëllim thellimin e hetimit administrativ në lidhje me aftësitë profesionale të subjektit. KLD³³ ka dërguar raportin me vlerësimin e pesë dosjeve gjyqësore shtesë për subjektin e rivlerësimit.

Në lidhje me parashtrimet e subjektit të rivlerësimit:

²⁹ Shih shkresën nr. *******, datë 10.04.2018, në dosjen e KPK

³⁰ Shih shkresën nr. *******, datë 30.05.2018, në dosjen e KPK

³¹ Shih shkresën nr. *******, datë, 01.06.2018, në dosjen e KPK

³² Shih shkresën nr. *******, datë 30.05.2018, në dosjen e KPK

³³ Shiko shkresën nr. *******, datë 23.04.2018, në dosjen e KPK

Në përgjigje të rezultateve paraprake të hetimit, subjekti i rivlerësimit më datë 23.07.2018, ka paraqitur propozimet lidhur me gjetjet e Komisionit, duke paraqitur spjegime të hollësishme si dhe proces verbalet e të gjitha çështjeve gjyqësore që janë marrë në shqyrtim, në mënyrë të permbledhur si vijojnë :

1. Në lidhje me çështjen gjyqësore me palë paditëse: AZHBR kundër: Shoqërisë “***” sh.p.k.

Është respektuar afati 7 ditor për caktimin e seancës përgatitore kurse afati 15 ditor nuk është respektuar vetëm për 1 ditë, për shkak të ngarkesës në punë por dhe pamundësisë së dy anëtarëve të tjerë të trupit gjykues për të gjetur një datë dhe një orar të përbashkët.

Lidhur me moslëshimin e vendimit apo urdhërit të ndërmjetëm, rezulton se ai është pasqyruar në procesverbalin e seancës përgatitore.

Lidhur me lajmërimin dhe mënyrën e lajmërimit të palëve, ky urdhër gjen pasqyrim në procesverbalin e seancës përgatitore të datës 16.06.2015. Në këtë seancë pala paditëse ka qenë prezent, prandaj nuk kishte nevojë për njoftim. Pala e paditur nuk ka qenë prezent prandaj njoftimet janë bërë me fletëthirrje, siç parashikohet nga neni 129 i Kodit të Procedurës Civile. Në këto rrethana njoftimi për këto palë ka qenë efektiv.

Lidhur me bazën ligjore, subjekti sqaroi se në zbatim të Vendimit Unifikues nr. 3, datë 29.03.2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, “*gjykata e zbulon shkakun e padisë së paditësit duke e analizuar padinë në tërësinë e saj dhe jo duke u kufizuar tek dispozitat ligjore të referuara nga paditësi në pjesën hyrëse të saj. Mund të ndodhë që paditësi të referojë gabimisht dispozitat ligjore, porse nga leximi i kërkesëpadisë del e qartë e drejta që ai kërkon të mbrojtë. Në këtë rast gjykata duhet të zgjidhë çështjen konform shkakut që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadisë, duke bërë lidhjen midis fakteve që pretendohen prej paditësit se kanë ngjarë dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon se i janë cenuar*”. Në këtë kuptim, për zgjidhjen e çështjes gjykata nuk është e detyruar që të mbështetet vetëm në bazën ligjore të parashikuar nga pala paditëse në kërkesëpadi.

Gjithashtu ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, e cila ka mbajtur të njëjtin qëndrim si nga pikëpamja e faktit ashtu edhe nga pikëpamja e interpretimit të ligjit. Në këto kushte, sikurse subjekti pretendon, analiza e çështjes është bërë e plotë dhe nuk ka pasur vend për trajtime të tjera ligjore.

2. Në lidhje me çështjen gjyqësore me palë paditëse: T.M kundër: Bashkisë Kurbin.

Lidhur me mungesën e veprimeve për thirrjen e seancës përgatitore dhe vendime dhe lajmërimet që kundërshtojnë njëra-tjetrën, u konstatua se në procesverbalin e datës 13.05.2016, ka një gabim material dhe një lapsus nga ana e sekretares gjyqësore, i bërë nga shpejtësia.

Në dosje ndodhen procesverbalet e seancave gjyqësore që provojnë rregullshmërinë e caktimit dhe zhvillimit të seancave gjyqësore në përputhje të plotë me ligjin.

Zbardhja e një vendimi apo një urdhëri të pasqyruar në procesverbalin e seancës gjyqësore, nuk është parë si domosdoshmëri nga ana e subjektit. Fletëthirrjet realizohen nga sekretaria gjyqësore, e cila ka marrë dijeni për urdhërin sepse është ajo që ka mbajtur procesverbalin.

Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin e datës 12.07.2018.

3. Në lidhje me çështjen gjyqësore me palë paditëse: F.C kundër: Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.

Rezulton se paditësi është paraqitur në seancën përgatitore të datës 24.07.2014. Seanca gjyqësore është caktuar përtej afatit 15 ditor për shkak të muajit gusht, i cili ka qenë muaj pushimi. Seanca gjyqësore nuk mund të caktohej në muajin korrik sepse gjykata duhet të mbante parasysh edhe një kohë të arsyeshme për të realizuar njoftimin e dëshmitarëve të kërkuar. Nuk ka pasur problematika në lidhje me realizimin e njoftimeve apo me zhvillimin e seancave gjyqësore. Palët kanë marrë dijeni rregullisht për seancat dhe kanë paraqitur pretendimet dhe prapësimet e tyre.

4. Në lidhje me çështjen gjyqësore me palë paditëse: Q.Z, kundër: Qendrës Ndërinstitucionale Detare Durrës.

Procesverbali i veprimeve përgatitore i datës 17.01.2014, në të cilin dokumentohen veprimet e gjykatës, ndodhet në dosje, dhe janë respektuar afatet pasi brenda 4 ditëve gjykata ka disponuar në lidhje me komunikimin e padisë dhe të akteve palës së paditur. Paditësi është paraqitur në seancën përgatitore të datës 20.02.2014, ora 12.00, çka tregon se njoftimi është kryer efektivisht. Nga seanca përgatitore në seancën gjyqësore ka kaluar një afat prej 13 ditësh (20.02.2014 – 05.03.2014). Të gjithë procesverbalet ndodhen në dosje ku vërtetojnë ligjshmërinë e veprimeve të kryera.

Lidhur me pasaktësinë e nenit 179 të ligjit nr. 49/2012, ndërkohe që duhet të ishte neni 179 i Kodit të Procedurës Civile, pretendohet se është një lapsus, gabim material në shkrim i bërë në shpejtësi e sipër nga ana e sekretares, gabim i cili ka shpëtuar pa u korrigjuar.

Të gjitha veprimet janë kryer në përputhje me ligjin. Nuk ka pasur problematika në lidhje me realizimin e njoftimeve apo me zhvillimin e seancave gjyqësore. Palët kanë marrë dijeni për seancat rregullisht dhe kanë paraqitur pretendimet dhe prapësimet e tyre.

5. Në lidhje me çështjen gjyqësore me palë paditëse: N.H, kundër: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Në dosje ndodhen të gjitha procesverbalet ku vërtetohen veprimet e kryera. Seanca është shtyrë sepse për periudhën 02 - 03.10.2014 dhe 06 - 07.10.2018 subjekti ka qenë me leje (vendimi nr. 88, datë 29.09.2014, i Kryetarit të Gjykatës për lejen përkatëse).

Për këtë çështje nuk ka pasur gjithashtu problematika në lidhje me realizimin e njoftimeve apo me zhvillimin e seancave gjyqësore pasi palët kanë marrë dijeni për seancat gjyqësore.

6. Në lidhje me çështjen gjyqësore me palë paditëse: P.N, kundër: ILDKPKI.

Është respektuar afati 7 ditor për veprimet përgatitore i parashikuar nga neni 25/1 i ligjit nr. 49/2012. Në dosje ndodhen procesverbalet e seancave gjyqësore që dokumentojnë të gjitha veprimet e kryera në përputhje të plotë me ligjin. Palët kanë marrë dijeni për seancat të cilat janë zhvilluar rregullisht.

7. Në lidhje me çështjen gjyqësore me palë paditëse: b.B, kundër: Degës së Tatimeve Elbasan.

Rezulton se është respektuar afati 7 ditor për veprimet përgatitore i parashikuar nga neni 25/1 i ligjit nr. 49/2012. Në dosje ndodhen procesverbalet e seancave gjyqësore që dokumentojnë të gjitha veprimet ligjore. Nuk ka pasur pronlemtika në lidhje me realizimin e njoftimeve apo me zhvillimin e procesit gjyqësor. Disponimet e gjykatës janë pasqyruar në procesverbalet e veprimeve përgatitore. Pala paditëse ka marrë dijeni për plotesimin e të metave, nuk i ka plotësuar ato brenda afatit ligjor të përcaktuar nga gjykata dhe për këtë arsye, gjykata ka vendosur kthimin e kërkesëpadisë dhe të akteve. Vendimi i është njoftuar palës paditëse, e cila nuk ka paraqitur ankim ndaj vendimit për kthimin e kërkesëpadisë dhe akteve.

8. Në lidhje me çështjen gjyqësore me palë paditëse: E.M, kundër: ISSH.

Çështja është regjistruar më datë 17.05.2016. Rezulton se është respektuar afati 7 ditor për veprimet përgatitore i parashikuar nga neni 25/1 i ligjit nr. 49/2012. Procesverbali i veprimeve përgatitore i datës 03.06.2016, që dokumenton veprimet e gjykatës, ndodhet në dosje. Është respektuar afati 15 ditor për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore i parashikuar nga neni 27/1 i ligjit nr. 49/2012.

Të gjitha veprimet janë kryer në përputhje të plotë me ligjin. Nuk ka pasur ndonjë konfuzion në lidhje me realizimin e njoftimeve apo me zhvillimin e seancave përgatitore dhe gjyqësore pasi palët kanë marrë dijeni për seancat rregullisht dhe kanë paraqitur pretendimet dhe prapësimet e tyre.

9. Në lidhje me çështjen gjyqësore me palë paditëse: A.B, kundër: INUK.

Rezulton se është respektuar afati 7 ditor për veprimet përgatitore i parashikuar nga neni 25/1 i ligjit nr. 49/2012 dhe është respektuar afati 15 ditor për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore i parashikuar nga neni 27/1 i ligjit nr. 49/2012. Në dosje janë procesverbalet e seancave gjyqësore të cilat dokumentojnë veprimet ligjore të kryera, si njoftimet për seancat, njoftimet e palëve, etj

10. Në lidhje me çështjen paditës: Shoqëria “***” sh.p.k., kundër: Komisionit të Prokurimit Publik.

Për këtë çështje gabimisht subjekti pranon se ka shënuar të dhënat me palë paditëse shoqërinë “***” sh.p.k. ”Në procesverbalin e mbajtur për dorëzimin e akteve rezulton që kam dorëzuar vendimin nr. 5186, datë 29.09.2014 (pika 33 e procesverbalit). Prandaj, me të drejtë KLD i është referuar vendimit nr. 5186, dtatë 29.09.2014”.

Konstatimi se për këtë çështje gjykatës iu desh më shumë se 1 vit për të dalë në vendimin përfundimtar nuk është i saktë. Çështja është regjistruar më datë 18.02.2014 dhe ka përfunduar më datë 29.09.2014.

Është respektuar afati 7 ditor për veprimet përgatitore i parashikuar nga neni 25/1 i ligjit nr. 49/2012 dhe është respektuar afati 15 ditor për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore i parashikuar nga neni 27/1 i ligjit nr. 49/2012 (09.07.2014 - 16.07.2014). Në dosje ndodhen procesverbalet ku dokumentohen veprimet e gjykatës, të ndjekura sipas ligjit.

Vendimi përfundimtar i gjykatës është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 3750, datë 09.11.2016. Veprimet janë kryer në përputhje me ligjin. Nuk ka pasur ndonjë konfuzion në lidhje me realizimin e njoftimeve apo me zhvillimin e seancave gjyqësore, në të cilat palët kanë marrë dijeni për seancat si dhe kanë paraqitur pretendimet dhe prapësimet e tyre.

11. Në lidhje me çështjen A.Z kundër Universitetit të Mjekësisë dhe Fakultetit të Mjekësisë.

Në dosje ndodhen procesverbalet ku dokumentohen veprimet e gjykatës, të ndjekura sipas ligjit. Është respektuar afati 7 ditor për veprimet përgatitore i parashikuar nga neni 25/1 i ligjit nr. 49/2012 dhe është respektuar afati 15 ditor për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore i parashikuar nga neni 27/1 i ligjit nr. 49/2012 (15.09.2015 - 30.09.2015). Vendimi përfundimtar i gjykatës është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 518, datë 10.03.2016. Seancat gjyqësore dhe të gjitha veprimet janë kryer në përputhje me ligjin. Palët kanë marrë dijeni për seancat ku kanë paraqitur pretendimet dhe prapësimet e tyre.

12. Në lidhje me çështjen “***” sh.p.k., kundër Komisionit të Prokurimit Publik.

Në dosje ndodhen procesverbalet ku dokumentohen veprimet e gjykatës, të ndjekura sipas ligjit. Është respektuar afati 7 ditor për veprimet përgatitore i parashikuar nga neni 25/1 i ligjit nr. 49/2012. Subjekti pranon se seanca gjyqësore është caktuar përtej afatit 15 ditor për shkak se muaji gusht është muaj pushimi. Për këtë arsye, gjykata duhet të mbante parasysh një kohë të arsyeshme për të realizuar njoftimin e palëve si dhe arsyetimin e vendimit brenda afatit ligjor. Të gjitha veprimet e tjera janë kryer në përputhje me ligjin. Palët kanë marrë dijeni për seancat ku kanë paraqitur pretendimet dhe prapësimet e tyre.

13. Në lidhje me çështjen shoqëria “***” sh.p.k., kundër Komisionit të Prokurimit Publik.

Për këtë çështje, në formularin e plotësuar nga subjekti, është shënuar gabim objekti i gjykimit dhe palët pjesëmarrëse në gjykim. Nga aktet, rezulton se është respektuar afati 7 ditor për veprimet

përgatitore i parashikuar nga neni 25/1 i ligjit nr. 49/2012, si dhe është respektuar afati 15 ditor për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, i parashikuar nga neni 27/1 i ligjit nr. 49/2012 (04.11.2014 - 17.11.2014). Po kështu, të gjitha veprimet janë kryer në përputhje me ligjin dhe vërtetohen me procesverbalet përkatëse. Nuk ka pasur ndonjë problematikë në lidhje me realizimin e njoftimeve për palët apo me zhvillimin e seancave gjyqësore.

Përgjithësisht, përsa u takon gjetjeve të Komisionit, me kalimin e barrës së provës, subjekti argumenton se:

-Në lidhje me standardin e vendosur me aneksin e vlerësimit të gjyqtarëve, duke iu referuar vendimit nr. 261/2, datë 14.04.2010, ky aneks vlerësimi në përcaktimin e standardit 30-ditor i referohet nenit 327 të Kodit të Procedurës Civile, i cili është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 49/2012. Ligji nr. 49/2012 kërkon një gjykim brenda afateve të arsyeshme dhe nuk vendos një afat fiks 30-ditor në lidhje me përfundimin e gjykimit.

-Në lidhje me standardin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, ngarkesa në punë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është tejet e lartë, ku janë caktuar për gjykim 2094 çështje, nga të cilat kanë përfunduar 1864 çështje, pra një ngarkesë është afërsisht 3-fishi i standardit të ngarkesës për gjyqtar. Një volum i tillë çështjesh që paraqiten për gjykim e bën fizikisht të pamundur respektimin e afateve. Secila çështje kërkon kohën e nevojshme për të studiuar aktet e paraqitura, bazën ligjore, studiuar pretendimet e palëve, zhvilluar seancat dëgjimore, mbajtur procesverbalet e veprimeve përgatitore, të seancave përgatitore dhe atyre gjyqësore dhe, më pas, për të vendosur në lidhje me çështjen dhe arsyetuar vendimin. Të gjitha këto procese duhet të vendosen në harkun kohor prej 8 orësh punë në dite, që është orari zyrtar. Duke parë numrin shumë të lartë të çështjeve të paraqitura për gjykim, orari zyrtar nga ora 8:00-16:00 është shfrytëzuar kryesisht për realizimin e seancave përgatitore dhe gjyqësore, ku janë zhvilluar 10, 12 e deri në 18 seanca në ditë. Të gjitha veprimet e tjera në lidhje me studimin e dosjes, akteve, bazës ligjore, literaturës përkatëse dhe arsyetimi i vendimeve është bërë pas orarit zyrtar të punës. Gjatë periudhës së rivlerësimit subjekti deklaroi se ka punuar 12, 14 dhe 16 orë në ditë, pothuajse çdo ditë, përfshirë edhe ditët e pushimit.

-Në lidhje me numrin e seancave të zhvilluara çdo ditë, bashkëngjitur janë kopje të kalendarit të gjykatës, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, nga ku mund të shikohen lehtësisht numri i seancave të zhvilluara çdo ditë.

-Larmia dhe kompleksiteti i çështjeve janë elemente që ndikojnë në kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore. Secila nga çështjet ka specifikën e vet dhe për secilën duhet një kohë e nevojshme përgatitjeje dhe studimi. Kompleksiteti i çështjeve është një element tjetër që ndikon në kohën që i duhet gjyqtarit për të vendosur në lidhje me çështjen. Në Gjykatën Administrative gjykohen konflikte mes shoqërive tregtare dhe organeve tatimore dhe doganore, të cilat paraqesin vështirësi në gjykimin e tyre sepse kanë shumë problematika në vetvete, të cilat kërkojnë secila kohën e tyre.

-Në lidhje me kohëzgjatjen e një procesi ndikon natyra e çështjes dhe kërkesat që palët paraqesin gjatë zhvillimit të gjykimit, siç janë rregullimi i ndërgjyqësisë, rregullimi i objektit të padisë, kërkesat për të marre prova te të tretët. Vlerësoj se nuk mund të refuzohet një kërkesë palës me qëllimin e vetëm që gjykimi të përfundojë në një kohë të shpejtë. Vlerësoj se gjykimi duhet të përfundojë në kohën më të shpejtë të mundshme, pa cënuar të drejtat e palëve. Nëse do t'u referoheni çështjeve të trajtuara më lart, në rastet e veçanta do të konstatohet se gjykimi ka zgjatur për shkaqe që kanë lidhje me rregullimin e ndërgjyqësisë, me rregullimin e objektit të padisë, thirrjen e personave të tretë dhe respektimin e të drejtave procedurale të secilës palë që është thirrur rishtas në gjykim për t'u njohur me padinë dhe aktet. Rregullimi i ndërgjyqësisë dhe i objektit të padisë janë veprime që janë në disponibilitet të palëve në proces.

-Nuk duhet harruar edhe elementi subjektiv që gjyqtari është një qenie njerëzore, i cili ka nevojat veta bazike. Sa më sipër, në të gjitha rastet, gjykimi ka përfunduar brenda një afati të arsyeshëm, duke mos cenuar standardin "gjykim brenda një afati të arsyeshëm".

Duke iu referuar kësaj mangësie të konstatuar, në asnjë nga çështjet e verifikuara ky fakt nuk ka përberë pengesë në mbarëvajtjen e procesit. Përkundrazi, njoftimet për palët janë realizuar rregullisht. Palët janë paraqitur në gjykim dhe nuk kanë ngritur ndonjë pretendim në lidhje me njoftimin. Nuk ka pasur ndonjë konfuzion në lidhje me realizimin e njoftimeve apo me zhvillimin e seancave gjyqësore. Çështjet janë zhvilluar normalisht. Palët kanë marrë dijeni për seancat rregullisht, kanë paraqitur pretendimet dhe prapësimet e tyre dhe nuk ka pasur ndonjë paqartësi.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë ka mbajtur të njëjtin qëndrim, si nga pikëpamja e faktit, ashtu edhe nga pikëpamja e interpretimit të ligjit. Në këto kushte, analiza e çështjes është bërë e plotë dhe nuk ka pasur vend për trajtime të tjera ligjore.

Vlerësimi i aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit Gentian Medja, në kuadër të rivlerësimit kalimtar të tij sipas ligjit nr. 84/2016, është bazuar në :

- Aneksin e Kushtetutës-neni E, pika 1, përcakton qëllimin e vlerësimit profesional, duke përcaktuar ata që nuk janë të përshtatshëm për të kryer këtë detyrë (shkak për largimin nga detyra sipas parashikimit të nenit 61, pika 4) dhe ata që kanë mangësi profesionale të cilat mundet të rregullohen nëpërmjet edukimit/ arsimimit (sipas parashikimit të germës "b" të pikës 1 të nenit 58 të ligjit) .

- Ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe konkretisht:

Neni 72 (që parashikon aftësitë profesionale)

Neni 74 (që parashikon aftësitë organizative)

Neni 75 (që parashikon etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale)

Neni 76 (që parashikon aftësitë profesionale dhe angazhimin profesional)

- Ligji nr. 84/2016 (neni 44), që parashikon përcaktimet/ vlerësimet përfundimtare për aftësitë profesionale (“*I aftë*”, “*Me mangësi*”, “*I papërshtatshëm*”).

Sipas parashikimit të neneve 72 dhe 74 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë hetimit paraprak për subjektin e rivlerësimit u konstatuan gjetjet si vijojnë :

1. Mosrespektim i afateve ligjore në gjykimin e çështjeve.

Lidhur me këtë, subjekti paraqiti si argument, faktin se afati 30-ditor për përfundimin e gjykimit të çështjeve, i përcaktuar në nenin 327 të Kodit të Procedurë Civile, është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 49/2012, i cili përcakton gjykimin brenda afateve të arsyeshme, pa caktuar një afat konkret. Gjithashtu, subjekti justifikoi (duke paraqitur prova) shtyrjen e afateve të gjykimit, edhe me ngarkesën e lartë në punë.

2. Parregullsi në kryerjen e veprimeve proceduriale për thirrjen dhe shtyrjen e seancave përgatitore dhe ato gjyqësore, mosnxjerrja e vendimeve të ndërmjetme, mosvërtetimi i njoftimit të palëve me dokument shkresor, si dhe mungesa e procesverbaleve në dosjet e marra në shqyrtim nga KLD.

- Lidhur me mungesën e procesverbaleve, Komisioni vëren, se është Inspektoriati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë që duhet të vinte në dispozicion të Komisionit, procesverbalet e seancave gjyqësore për çështjet që ka marrë në shqyrtim, dhe jo subjekti i rivlerësimit.

Por, pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit, ka paraqitur procesverbalet gjyqësore për të gjitha seancat gjyqësore të çështjeve të marra në shqyrtim.

- Lidhur me parregullsitë e konstatuara gjatë veprimeve përgatitore, në procesverbalet e paraqitura prej subjektit, konstatohet se përgjithësisht procedurat janë kryer rregullisht dhe palët janë njoftuar gjatë seancave gjyqësore (kur kanë qenë prezente), ose në mënyra të tjera që ligji i lejon, edhe pse nuk ka pasur akte shkresore të posaçme. Neni 148 i Kodit të Procedurave Administrative, parashikon se njoftimi i palëve për seancë, mund të bëhet verbalisht kur pala është e pranishme, ose në çdo mënyrë tjetër të përshtatshme të njoftimit, sipas përcaktimeve në dispozitat ligjore të këtij ligji.

- Lidhur me urdhrat dhe vendimet e ndërmjetme të munguara, neni 25 i ligjit nr. 49/2012, “ Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, parashikon procedurat për kryerjen e veprimeve përgatitore, dhe në pikën 2 të tij përcakton se *“të gjitha këto veprime të gjyqtarit kryesues kryhen me vendime të ndërmjetme dhe dokumentohen në procesverbalin e veprimeve përgatitore, që përpilohet nga sekretari gjyqësor dhe nënshkruhen prej tij dhe gjyqtarit kryesues”*. Ndërkohë, neni 27 i këtij ligji, parashikon procedurat për lëshimin e urdhërit për caktimin e seancës gjyqësore dhe përmbajtjen e tij, nga ana e gjyqtarit.

Për mangësitë e konstatuara në këtë drejtim, subjekti ka argumentuar duke vërtetuar me procesverbalet e seancave gjyqësore, së të gjitha veprimet e kryera prej tij, urdhërat dhe vendimet e ndërmjetme gjatë seancave përgatitore dhe gjyqësore, edhe pse nuk janë pasqyruar në akte me vete, (në rastet kur janë konstatuar) janë të dokumentuara në procesverbalet e seancave gjyqësore (ashtu sikurse neni 25 i ligjit nr. 49/2012 e lejon), duke i justifikuar mangësitë me ngarkesën e lartë në punë të tij dhe të sekretarisë gjyqësore.

Për të vërtetuar ngarkesën e lartë në punë, subjekti ka paraqitur kalendarët e çështjeve gjyqësore, nga të cilat rezulton se ai ka punuar 12-16 orë në ditë, si dhe janë zhvilluar nga 10,12-18 seanca në ditë. Gjithashtu, si shkak për vonesat dhe mangësitë proceduriale ekzistente, subjekti ka pretenduar dhe argumentuar larminë dhe kompleksitetin e çështjeve, gjë që kërkon kohën e duhur për shqyrtimin e çështjeve në sasinë dhe cilësinë e duhur.

3. Referencat e gabuara ligjore.

Subjekti ka pranuar që mund të ketë ndodhur në ndonjë rast shënimi i gabuar i referencave ligjore në procesverbalet e seancave, për shkak të ngarkesës në punë të tij, por dhe të sekretarisë gjyqësore.

Ndërsa në rastin kur është konstatuar se është zbatuar referencë ligjore e ndryshme nga ajo e kërkesëpadsisë, subjekti ka argumentuar se me vendimin unifikues, nr. 3, datë 29.03.2012, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, *“Gjykata e zbulon shkakun e padisë së paditësit duke e analizuar padinë në tërësinë e saj dhe jo duke u kufizuar te dispozitat ligjore të referuara nga paditësi në pjesën hyrëse të saj. Mund të ndodhë që paditësi të referojë gabimisht dispozitat ligjore, porse nga leximi i kërkesëpadsisë del e qartë e drejta që ai kërkon të mbrojë. Në këtë rast gjykata duhet të zgjidhë çështjen konform shkakut që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadsisë, duke bërë lidhjen midis fakteve që pretendohen prej paditësit se kanë ngjarë dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon se i janë cenuar”*.

Sipas parashikimit të neneve 75 dhe 76 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” nuk ka të dhëna apo gjetje negative nga regjistri i ankesave dhe procedimeve disiplinore. Gjithashtu nuk rezultuan të dhëna negative lidhur me trajtimin e çështjeve.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, lidhur me të metat e konstatuara, sipas parashikimit të nenit 72 dhe 74 të ligjit nr. 96/2016, shumica e trupit gjykues çmoi se:

- Subjekti ka pasur një ngarkesë të lartë në punë (sa trefishi i ngarkesës mesatare për një gjyqtar të shkallës së parë), gjë që u vërtetua me të dhënat statistikore të KLD-së, prapësimet e parashtruara dhe dokumentat e paraqitura nga subjekti më datë 23.07.2018, bazuar në dokumenta shkresore (procesverbalet e seancave gjyqësore dhe kalendarët e zhvillimit të gjyqeve), si dhe faktin e njohur botërisht mbi ngarkesën në punë të Gjykatës Administrative të Tiranës, që në momentin e krijimit të saj në vitin 2013, e në vazhdim, ku çështjet e pagjykuara kanë qënë dhe vazhdojnë të jenë të mbartura vit pas viti.
- Pasi ushtroi të drejtën e barrës së provës, subjekti rrëzoi disa nga parregullsitë procedurale të konstatuara gjatë procesit të rivlerësimit profesional, të përmendura më sipër në këtë vendim. Mangësitë ekzistente, në përfundim të procesit të rivlerësimit, nuk vërtetojnë që subjekti ka njohuri, aftësi në gjykim, qëndrime ose modele pune aq të dobëta, sa të kenë rrezikuar dhe cënuar të drejtat e qytetarëve. Në asnjë nga çështjet e verifikuara nuk vërtetohet që këto parregullsi të jenë bërë pengesë në mbarëvajtjen e procesit si dhe subjekti të kenë shkelur të drejtat e palëve në proces. (neni E, pika 5, e Aneksit të Kushtetutës).
- Përsa i përket afateve të gjykimit, subjekti ka detyrimin për të vepruar sipas ligjit numër 49/2012 “për Gjykatat Administrative” i cili ka parashikuar një afat të arsyeshëm për gjykimin çështjeve administrative, pa percaktuar një afat konkret.
- Përsa i përket shtyrjes së afateve gjatë gjykimit të çështjeve, është e vërtetë se kjo mund të konsiderohet e barazvlefshme me një “*mosdhënie drejtësie*”. Në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Gentian Medja, nisur nga të gjitha sa më sipër janë arsyetuar në këtë vendim, por edhe nga vlerësimi tërësor i procedurave, duke pasur në konsideratë vlerësimin e pasurive, vlerësimin e figurës së subjektit, numrin e pakët të denoncimeve, në adresë të tij, nuk vërtetohet që ky paralelizëm të jetë i vërtetë. Përpos kësaj, “*Mosdhënia e drejtësisë*” nga ana e subjektit të rivlerësimit do të kishte reflektuar sadopak në vlerën pasurore të aseteve të tij, apo në etikën dhe pastërtinë të figurës, për të cilat nuk kanë rezultuar ankesa apo të dhëna negative nga burime të çdo lloji qofshin.
- Duke marrë në konsideratë se një nga qëllimet e ligjit nr. 84/2016 është rikthimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, konstatohet se në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Gentian Medja, nuk ka elemente që tregojnë se ai ka cënuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

Sa më sipër, për të arritur në një përfundim lidhur me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Gentian Medja, shumica e trupit gjykues konkludon se :

Mangësitë e konstatuara gjatë ushtrimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit nuk të tilla sa ai të konsiderohet i papërshtatshëm (pika 4 dhe 5 e neni

t E të Kushtetutës dhe neni 61, pika 4, i ligjit), apo të tilla që të mundësohet rikuperimi me program trajnimi (pika 3 e nenit E të Kushtetutes dhe neni 60, pika 1, e ligjit).

Në përfundim të rivlerësimit profesional, sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi relatorja e çështjes ka propozuar që subjekti i rivlerësimit, z. Gentian Medja, të vlerësohet “i aftë”, në vlerësimin tërësor të procedurave, brenda kuadrit të zbatueshëm ligjor, me të gjitha mjetet dhe mënyrat që Kushtetuta, ligji nr. 84/2016 dhe ligji “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” lejon, si dhe bazuar në provat që subjekti paraqiti pasi ushtroi barrën e provës, nga ana e shumicës, u krijua bindja se subjekti i rivlerësimit e arrin nivelin minimal kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme, dhe për këto arsye është konsideruar “*I aftë*”.

V. KOMUNIKIMI ME SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT

Gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti ka qenë tërësisht bashkëpunues, i qartë e i sinqertë në deklarime, reflektues ndaj gjetjeve të konstatuara, duke dhënë shpjegime të detajuara e të bazuara në dokumente shkresore, brenda afateve të caktuara nga Komisioni, qëndrime të cilat janë marrë në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, sipas nenit 48 të ligjit.

VI. SEANCA DËGJIMORE

Në datën 30.07.2018, u zhvillua seanca dëgjimore sipas nenit 55 të ligjit 84/2016, për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit z. Gentian Medja, i cili u paraqiti personalisht pa praninë e një përfaqësuesi ligjor, seancë gjatë të cilës ai parashitroi pretendimet e tij lidhur me procesin e rivlerësimit.

Në përfundim të këtij procesi, trupi gjykuese, pasi dëgjoji relatoren e çështjes, komisionere Firdes Shuli, e cila rekomandoi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, dëgjoji subjektin, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë, dhe pasi administroi dokumentet shkresore: Aneks 1- dosja e

ILDKPKI-së; Aneks 2- dosja e Komisionit; Aneks -3 dosja e komunikimit me subjektin; Aneks 4 - dosja për vlerësimin profesional, përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Gentian Medja, dhe shpall me shumicë votash këtë vendim sot, më datë 01.08.2018, sipas nenit 59 të ligjit nr. 84/2016 dhe Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

VII. KONKLUSIONI PËRFUNDIMTAR

1. Referuar Aneksit të Kushtetutës, (neni D), ligjit nr. 84/2016, (kreu IV) lidhur me kriterin e pasurisë, trupi gjykues konkludon se për subjektin e rivlerësimit, Z. Gentian Medja :

- ✓ Nuk kanë rezultuar deklarime të pasakta dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, (neni 33, pika 5/a, e ligjit);
- ✓ Nuk ka mungesë e burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë (neni 33 pika 5/b e ligjit);
- ✓ Nuk ka fshehje pasurie, (neni 33, pika 5/c, e ligjit);
- ✓ Nuk ka deklarim të remë (neni 33, pika 5/c, e ligjit);
- ✓ Subjekti nuk është në situatë konflikti interesi (neni 33, pika 5/d, e ligjit).

2. Referuar Aneksit të Kushtetutës, (neni DH), ligjit nr. 84/2016, (kreu V) lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit, z. Gentian Medja, është i përshtatshëm për vazhdimin e ushtrimit të detyrës.

3. Referuar aneksit të Kushtetutes (neni E), ligjit nr. 84/2016 (kreu VI), subjekti i rivlerësimit është vlerësuar i aftë profesionalisht, nga shumica e trupit gjykues.

Bazuar në këto konkluzione, si dhe nga vlerësimi tërësor i procedurave, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit :

- ➔ Ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, (neni 59/a i ligjit);
- ➔ Ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, (neni 59/b i ligjit);
- ➔ Ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, (për shumicën), (neni 59/c i ligjit).

Subjekti i rivlerësimit, z. Gentian Medja, duhet të konfirmohet në detyrë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, bazuar në nenin 59 pika 1 të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe Aneksit të Kushtetutës së Shqipërisë, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit z. Gentian Medja, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë më 01.08.2018

TRUPI GJYKUES

Roland Ilia

Kryesues

Firdes Shuli

Relatore

Xhensila Pine

Anëtare në pakicë

Sekretare gjyqësore

Ina Serjanaj

MENDIM PAKICE

Si anëtare e trupit gjykues, pas analizimit të rezultateve të hetimit administrativ, provave të mbledhura nga ky hetim, si dhe shpjegimeve e provave të sjella nga subjekti i rivlerësimit, nuk pajtohem me arsyetimin dhe përfundimin e arritur nga ana e kolegëve të shumicës, për sa i përket vlerësimit të aftësive profesionale në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Gentian Medja, për sa më poshtë:

Per subjektin e rivlerësimit z. Gentian Medja, Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë vlerësimin profesional, sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, dhe ka hartuar e paraqitur pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit raportin me nr. *** prot. datë 15.02.2018.

KLD me raportin e saj ka evidentuar disa te meta/difekte në mënyrën e trajtimit të çështjeve gjyqësore nga ky gjyqtar. Gjithashtu trupi gjykues gjeti të tjera të meta të cilat nuk ishin pasqyruar në raportin e sjellë nga KLD.

Me vendimin nr. 2, datë 29.03.2018, trupi gjykues pas konstatimit të të metave, vendosi të thellojë hetimin administrativ në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimi, z. Gentian Medja.

Me vendimin nr. 3, datë 03.04.2018, trupi gjykues vendosi të përzgjedhë në mënyrë rastësore 5(pesë) çështje gjyqësore shtesë nga tabelat statistikore të paraqitura nga KLD-ja, të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit. Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, përgatiti raportin nr. 1079/8, datë 23.04.2018, për analizimin e pesë dosjeve shtesë.

Nga analizimi i të dhënave të:

- Dy raporteve për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Formularit të vetëdeklarimit, 3 dokumenteve ligjore dhe dokumenteve të tjera të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- 5 dosjeve gjyqësore të tjera të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- Të dhënave nga burimet arkivore të KLD-së;
- Informacioneve të marra nga burime të ligjshme;

Bazuar në nenin E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin Nr. 84/2016”Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë si dhe ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të të 13 çështjet, rezultuan lloje të ndryshme të metash, jo vetëm të meta të së njëjtit lloj. Këto të meta përsëriten në të gjitha çështjet, ose të paktën në shumicën e tyre. Duke marrë parasysh se 10 nga 13 çështjet janë përzgjedhur me short, rezulton se ka një model të metash, i cili nuk kufizohet vetëm në të meta rastësore por grupohen pa u kufizuar si më poshtë:

- Mosrespektim i afateteve ligjore në gjykimin e çështjeve;
- Parregullsi në kryerjen e veprimeve procedurale për thirrjen dhe shtyrjen e seancave përgatitore dhe ato gjyqësore, mosnxjerrje të vendimeve të ndërmjetme; mosnjoftim të palëve me dokument shkresor, e mungesë të procesverbaleve, dosje të paplota.
- Referenca të gabuara ligjore

I. Mosrespektim i afateve ligjore në gjykimin e çështjeve.

Arsyetimi i shumicës, në lidhje me këtë, bazohet në faktin se afati 30-ditor për përfundimin e gjykimit të çështjeve, i përcaktuar në nenin 327 të Kodit të Procedurës Civile, është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 49/2012, i cili përcakton gjykimin brenda afateve të arsyeshme, pa caktuar një afat konkret, si edhe me ngarkesën e lartë në punë të subjektit të rivlerësimit.

Në shpjegimet e dhëna për rezultatet e hetimit dhe gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, deklaroi se afati ligjor prej 30 ditësh, i parashikuar në nenin 327 të Kodit të Procedurës Civile, është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të ligjit të ri nr. 49/2012, për Gjykatat Administrative.

Afati prej 30 ditësh është standardi që zbaton KLD-së për vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, i cili është institucioni kompetent për kryerjen e vlerësimit kalimtar të aftësive profesionale që parashikon neni 179, pika 5 i Kushtetutës; neni 160, pika 1, shkronja “dh” dhe neni 173, pika 1, shkronja “a” i ligjit për Statusin.

Për pasojë, mendoj se argumentet e subjektit të rivlerësimit si dhe arsyetimi i shumicës për këtë çështje, duket se nuk mbajnë parasysh se nuk është Kodi i Procedurës Civile dhe as ligji për Gjykatat Administrative ai që parashikon kriteret e vlerësimit, por është ligji për Statusin dhe Vendimi përkatës i KLD-së.

II.Parregullsi në veprimet procedurale e mosnxjerrje të vendimeve të ndërmjetme.

Gjatë hetimit administrativ është konstatuar se dosjet e analizuara për vlerësimin profesional kanë qenë të paplota, pasi nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk janë dhënë vendime të ndërmjetme dhe as urdhra gjyqësorë. Në disa raste mungonin edhe proces-verbale gjyqësore të sekretarit gjyqësor, si dhe ka pasur gjithashtu parregullsi në veprimet parapërgatitore, si njoftimi e palëve, etj.

Arsyetimi i përdorur nga shumica për mangësitë e konstatuara me urdhrat dhe vendimet e ndërmjetme të munguara, bazohet në nenin 25 të ligjit nr. 49/2012 “ Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i cili parashikon procedurat për kryerjen e veprimeve përgatitore, dhe në pikën 2 të tij përcakton se “të gjitha këto veprime të gjyqtarit kryesues kryhen me vendime të ndërmjetme dhe dokumentohen në procesverbalin e veprimeve përgatitore, që përpilohet nga sekretari gjyqësor dhe nënshkruhen prej tij dhe gjyqtarit kryesues”.

Për mangësitë e konstatuara, subjekti ka argumentuar duke vërtetuar me procesverbalet e seancave gjyqësore, se të gjitha veprimet e kryera prej tij, urdhrat dhe vendimet e ndërmjetme gjatë seancave përgatitore dhe gjyqësore, edhe pse nuk janë pasqyruar në akte me vete, (në rastet kur janë konstatuar), janë të dokumentuara në procesverbalet e seancave gjyqësore (ashtu sikurse neni 25 i ligjit nr. 49/2012 e lejon), duke justifikuar mangësitë e konstatuara, me ngarkesën e lartë në punë të tij dhe të sekretarisë gjyqësore.

Mendoj se argumentet e subjektit të rivlerësimit si dhe arsyetimi i shumicës për këtë çështje, duket se nuk mbajnë parasysh parashikimet e ligjit për Gjykatat Administrative. Ky ligj nuk parashikon procesverbalet gjyqësore si zëvendësues të veprimtarisë gjyqësore, në mënyrë që të konsiderohen vendimet e ndërmjetme dhe urdhrat gjyqësore si “të panevojshëm”. Për më tepër, monitorimi i njoftimeve është kërkesë ligjore për kriterin e aftësive profesionale, siç parashikon neni 74 i ligjit për Statusin.

III. Referencat e gabuara ligjore.

Gjatë hetimit administrativ, është konstatuar se në disa raste, subjekti i rivlerësimit i është referuar gabimisht bazës ligjore përkatëse.

Arsyetimi i shumicës për këtë është se, subjekti i rivlerësimit ka pranuar që mund të ketë ndodhur në ndonjë rast shënimi i gabuar i referencave ligjore në procesverbalet e seancave, për shkak të ngarkesës në punë të tij, por dhe të sekretarisë gjyqësore. Ndërsa në rastin kur është konstatuar se është zbatuar referencë ligjore e ndryshme nga ajo e kërkesëpadsisë, shumica arsyeton se subjekti i rivlerësimit, në përgjigjen e tij, i është referuar Vendimit Unifikues, nr. 3/2012 të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit gjyqtari nuk është i detyruar t’i përmbahet bazës ligjore të padsisë.

Për sa më sipër mendoj se arsyetimi i shumicës për këtë çështje, nuk mban parasysh mospërputhjet e konstatuara në pjesën hyrëse të vendimit gjyqësor (jo të padsisë) me pjesën arsyetuese të vendimit, dhe bazës ligjore në të njëjtin vendim.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Nga analiza e të metave të konstatuara e të përsëritura, që procesi i rivlerësimit – përsa i përket vlerësimit profesional të mund të kontribuonte në mënyrë thelbësore në rritjen e aftësive profesionale të gjyqësorit në Shqipëri, arrij në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, ka një model pune e gjykim, të dobët, mos respektim të së drejtave të palëve, nuk është efektiv, në atë shkallë sa programi i trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës nuk mund të zgjidhte këtë çështje për një vit.

Për sa më sipër, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit, z. Gentian Medja nuk arriti një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, duke u konsideruar i papërshtatshëm, në lidhje me aftësitë profesionale prandaj shumica nuk duhet të kishte vendosur konfirmimin e tij në detyrë, por bazuar në nenin E pika 5 të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 61/4 e nenin 44/c, të Ligjit nr.

84/2016, si dhe nenet 72,74 të Ligjit nr. 96/2016, duhej te vendoste shkarkimin nga detyra të këtij subjekti.

ANËTAR

Xhensila PINE